

UDC 343.1 : 340.131

Armend Asllani, MA¹

Mirushe Asllani²

AKTET DHE STANDARDET NDËRKOMBETARE LIDHUR ME NDIHMËN POSTPENALE

МЕЃУНАРОДНИТЕ АКТИ И СТАНДАРДИ ВО ВРСКА СО ПОСТКРИВИЧНАТА ПОМОШ

THE ACTS AND INTERNATIONAL STANDARDS RELATING TO POST-PENALE ASSISTANCE

Abstract

Post-penale assistance as a very important form of institutional and final stage of re-socialization, at the same time, has a great importance in penitentiary systems. The fact known that the society once convicts person or recidivist labeled as possible in negative connotation, unpleasant situations are created for released persons. The perception and interpretation of the created situation will have its own difficulties and those convicted persons will face with problems of outreach social adaptation, cultural and ideological.

In particular, it has been carried out a succinct analysis of acts&international standards related with the post-penale assistance, specifically about Standart Minimum Rules of UN for the Treatment of Prisoners, as well as recommendations: R(87)3, R (2006)2 dhe R(82)16.

Key words: rules, recommendation, post-penale assistance.

Abstract

Ndihma postpenale, si formë mjaft e rëndësishme institucionale dhe njëherit fazë përmyllëse e risocializimit, ka një rëndësi të madhe në sistemet penitenciare. Nga fakti i njohur se shoqëria personin njëherë të dënuar, apo recidivistin e etiketon në konotacion sa më të mundshëm negativ, krijohen situata jo të këndshme për personat e liruar. Perceptimi dhe interpretimi i gjendjes së krijuar do të ketë vështirësitë e veta dhe personat e dënuar do të ballafaqohen me problemet e paarritura të adaptimit social, kulturor dhe ideologjik.

Në mënyrë të veçantë është bërë një analizë precize e akteve&standardeve ndërkombëtare lidhur me ndihmën postpenale, më konkretisht kemi të bëjmë me Rregullat standarde minimale të OKB-së për trajtimin e personave të burgosur, si dhe me rekomandimet: R(87)3, R (2006)2 dhe R(82)16.

¹ Magjistër i shkencave juridike-drejtimi penal, e-mail:asllaniarmend@gmail.com

² Magjistrate në shkencat juridike (master cand.).

Fjalët kyçe: rregulla, rekomandim, ndihmë postpenale.

1. Rregullat standarde minimale të OKB-së për trajtimin e personave të burgosur³

Qëllimi i këtyre rregullave nuk është përshkrimi i ndonjë mostre të sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale në institucionet penale. Me këto thjesht dëshirohet të vendosen principet e gjithpranuara për kryerjen e dënimit dhe praktikën e vendosjes me personat e burgosur, në bazë të kuptimit të deritanishëm dhe sipas cilësimeve bazike të sistemeve më të mira bashkëkohore⁴.

Pjesa e parë e këtyre Rregullave i përcakton dispozitat për administratën e institucioneve korrektuese dhe aplikohen për të gjitha kategoritë e të burgosurve, për ato që janë të privuar nga liria sipas drejtës penale ose civile, të fajësuar ose të gjykuar, duke inkuadruar këtu edhe të burgosurit ndaj të cilëve është e aplikuar edhe ndonjë “masë e sigurisë” ose masë edukative të cilën e ka caktuar gjykatësi⁵.

Pjesa e dytë përmban dispozita, të cilët mundën të aplikohen vetëm te kategoritë e veçanta të personave të burgosur, për të cilën bisedohet në secilin repart. Megjithatë, dispozitat nga reparti A, në të cilën aplikohen ndaj personave të dënuar, do të aplikohen edhe ndaj kategorive të personave të burgosur të përmendur në repartet B, C dhe D, në qoftë se nuk janë në kundërshtim me dispozitat dhe me kusht që të jenë të dobishëm për këta persona të burgosur⁶.

Me lirimimin e të burgosurve nuk ndërpritet përgjegjësia e shoqërisë. Për atë duhet të jenë në dispozicion institucionet shtetërore dhe private, që janë në situatë personit të burgosur të sapoliruar t’i ofrojnë ndihmë efikase pas daljes nga burgu dhe që në të ardhmen, do të aspirojnë për zbutjen e paragjyqimeve në lidhje me të burgosurit dhe normalisht, se do t’iu ndihmohet përsëri të kthehen në shoqëri⁷.

³ Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners (Adopted by the First United Nations Congress on the Prevention of Crime and the Treatment of offenders, held at Geneva in 1955, and approved by the Economic and Social Council by its resolutions 663 C (XXIV) of 31 July 1957 and 2076 (LXII) of 13 May 1977. [http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/Treatment Of Prisoners.aspx](http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/Treatment%20Of%20Prisoners.aspx) (02.05.2013)

⁴ Ibid, paragrafi 1

⁵ Ibid, paragrafi 4, pika 1

⁶ Ibid, paragrafi 4, pika 2

⁷ Ibid, paragrafi 64

Sa i përket ndihmës postpenale, kemi disa dispozita që i parasheh ky dokument ndërkombëtar, ato janë:

- Kujdes të veçantë, duhet kushtuar mirëmbajtjes dhe përmirësimit të raporteve ndërmjet personave të burgosur dhe familjeve të tyre, kur ajo është e dëshiruar dhe në interes të të dy palëve⁸.
- Prej fillimit të dënimit duhet të merret parasysh edhe ardhmëria e të burgosurve pas lirimit të tyre. I burgosuri duhet të inkurajohet që të mbajë dhe të krijojë raporte të tilla me personat dhe organizatat jashtë institucionit që do të ishin në interes të familjeve të tyre dhe gjithashtu edhe në interes për riedukimin e tyre personal shoqëror⁹.
- Shërbimet shtetërore dhe ndërshtetërore (ndërkombëtare) dhe organizatat, që i ofrojnë ndihmë të burgosurve, pas lirimit të tyre në kufi të mundësive duhet, që këtyre personave t'iu sigurohet dokumentacion i veçantë dhe mjete të identifikimit, banesë, punë, veshmbathje serioze, e cila iu përgjigjet klimës dhe kohës vjetore, si dhe mjete tjera të veçanta që të arrijnë deri te vendi i caktuar dhe të kenë mundësi të jetojnë në mënyrë normale direkt pas daljes në liri¹⁰.
- Përfaqësuesit kompetent të atyre organizatave, duhet të kenë qasje në institucionet dhe tek personat e burgosur. Prej vetë fillimit të dënimit nga ato duhet të kërkohet mendim, për propozimet e riedukimit të personave të burgosur¹¹.
- Është e dëshiruar që aktivitetet e këtyre organeve, të jenë sa më të centralizuara dhe të harmonizuara, me qëllim që sa më mirë të shfrytëzohen përpjekjet e tyre¹².

⁸ Ibid, paragrafi, 79

⁹ Ibid, paragr.80, pika 1

¹⁰ Ibid, paragr.81, pika 1

¹¹ Ibid, paragr.81, pika 2

¹² Ibid, paragr.81, pika 3

2. Rekomandimi R (87)3 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi rregullat evropiane të burgjeve¹³

(Miratuar nga komiteti i ministrave më 12 shkurt, 1987 në takimin e 404 të zëvendës ministrave)

Të gjithë të burgosurve duhet t'i ofrohet ndihmë, për rikthim të suksesshëm në shoqëri, në jetë familjare dhe në punësim pas lirimit. Për atë qëllim, duhet të kryhen (realizohen) veprime të caktuara dhe kurse të nevojshme¹⁴.

Për të burgosurit me dënime të gjata kohore, duhet të ndërmerren masa të nevojshme, që e mundësojnë gradualisht kthimin në jetën shoqërore. Ky qëllim mundet të arrihet me realizimin e tretmanit të veçantë paralëshues, i organizuar në të njëjtin ose institucion tjetër ose lirim me kusht me njëfarë lloji të mbikëqyrjes i kombinuar me mbështetje konkrete nga shoqëria¹⁵.

Administratat e burgut duhet ngushtë të koepërojnë me qendrat sociale, të cilët u ndihmojnë ish të burgosurve në rehabilitimin e tyre, veçanërisht në pikëpamje të jetës familjare dhe punësimit¹⁶.

Duhet të sigurohet, që gjatë lëshimit nga institucionet korrektuese të burgosurit (personat e dënuar) të fitojnë sipas nevojës dokumente të përshtatshme dhe t'u ndihmohet, që të gjejnë akomodim të rehatshëm si dhe vend pune. Gjithashtu duhet ndihmuar edhe me mjete të nevojshme për fillimin e jetës në liri dhe me veshmbathje të përshtatshme duke pasur parasysh kushtet dhe kohën vjetore, si dhe qysh t'u sigurohen të holla të nevojshme për arritjen në destinacionet e tyre¹⁷.

Përfaqësuesve të qendrave të përshtatshme sociale, duhet t'u lejohet qasje në institucionin dhe deri tek të burgosurit, që të japin kontribut të plotë programit për lëshim (lirim), si dhe programeve të ndihmës për personat e burgosur pas lirimit¹⁸.

¹³ Recommendation No.R (87)3 of the Committee of Ministers to Member States on the European Prison Rules (Adopted by the Committee of Ministers on 12 February 1987 at the 404 th meeting of the Ministers' Deputies). (<http://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1977676&Se cMode=1&DocId=692778&Usage=2>) (02.05.2013)

¹⁴ Ibid, paragr.87

¹⁵ Ibid, paragr.88

¹⁶ Ibid, paragr.89, pika 1

¹⁷ Ibid, paragr.89, pika 2

¹⁸ Ibid, paragr.89, pika 3

3. Rekomandimi Rec (2006)2 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi rregullat evropiane të burgjeve¹⁹

(Miratuar nga komiteti i ministrave më 11 Janar , 2006 në takimin e 952 të zëvendës ministrave)

Rregullat e burgjeve evropiane në një seksion të veçantë të quajtur, përcaktimi i lirit të të burgosurve, të cilat hapa duhet të ndërmerren për të siguruar, që të burgosurit e liruar sipas nevojës së tyre u janë dhënë dokumentet e duhura dhe dokumentet e identifikimit, dhe të ndihmohen në gjetjen e një strehimi dhe pune të përshtatshme²⁰.

Prandaj, të burgosurit e liruar do të jenë gjithashtu të pajisur me mjete të menjëhershme për ekzistencë, të jenë të veshur në mënyrë të përshtatshme me klimën dhe sezonin, dhe të kenë mjete të mjaftueshme për të arritur në destinacionin e tyre²¹.

Kur një i burgosur shqyrtohet nga personeli mjekësor, ose një infermiere e kualifikuar duke raportuar tek një mjek i tillë shëndetësor, ai mjek duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë për të vënë në dukje defektet mentale, ose fizike që mund të nxjerrin pengesa, në zhvendosjen pas lirit dhe duke bërë marrëveshje me agjencitë e komunitetit, për vazhdimin e ndonjë trajtimi të nevojshëm shëndetësorë, ose psikiatrik pas lirit, nëse të burgosurit japin pëlqimin e tyre në marrëveshje të këtilla²².

Përveç rregullave, të cilat vlejné për të gjithë të burgosurit, regjimi për të burgosurit e dënuar duhet të jetë i dizajnuar për t'iu mundësuar atyre për të udhëhequr një jetë përgjegjëse dhe pa krim²³.

Pas pranimeve të tilla, sa më shpejtë të jetë e mundur, raportet duhet të hartohen për të burgosurit e dënuar që kanë të bëjnë me situatat e tyre personale, plane të propozuara për dënim për secilin prej tyre, si dhe për përgatitjen e strategjisë për lirin e tyre²⁴.

Të burgosurit e dënuar duhet të jenë të inkurajuar për të marrë pjesë në hartimin e planeve të tyre individuale në lidhje me dënimin²⁵.

¹⁹ Recommendation Rec (2006) 2 of the Committee of Ministers to member states on the European Prison Rules (Adopted by the Committee of Ministers on 11 January 2006 at the 952nd meeting of the Ministers' Deputies). <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=955747> (Accessed at: 07.05.2013)

²⁰ Ibid, paragr.33.7

²¹ Ibid, paragr.33.8

²² Ibid, paragr.42.3, h and j.

²³ Ibid, paragr.102.1

²⁴ Ibid, paragr.103.2

Autoritetet e burgut duhet të punojnë ngushtë me shërbimet dhe agjencitë, të cilët i mbikëqyrin dhe i ndihmojnë të burgosurit e liruar, për t'iu mundësuar të gjithë të burgosurve të dënuar që ta rivendosin veten e tyre në komunitet, duke veçuar atë që kanë të bëjnë me jetën familjare dhe punësimin²⁶.

Përfaqësuesit e shërbimeve, apo agjencive të tilla sociale, duhet t'iu ofrohen të gjithë qasjet e nevojshme, burgut dhe të burgosurve, për t'i lejuar atyre të ndihmohen për përgatitjet dhe planifikimin e programeve pas kujdesore²⁷.

²⁵ Ibid, paragr.103.3

²⁶ Ibid, paragr.107.4

²⁷ Ibid, paragr.107.5

4. Rekomandimi R(82)16 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për lirim nga burgu²⁸

(Miratuar nga komiteti i ministrave më 24 Shtator, 1982 në takimin e 350 të zëvendës ministrave)

Komiteti i ministrave sipas kushteve të nenit 15b të Statutit të Këshillit të Evropës,

Duke pasur parasysh se, kjo është në interes të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës për të vendosur parimet e përbashkëta në politikën e krimit;

Duke pasur parasysh se largimi nga burgu kontribuon drejtë bërjes së burgjeve më humane dhe përmirësimin e kushteve të arrestit;

Duke pasur parasysh se largimi nga burgu është një nga mjetet për të lehtësuar riintegrimin social të të burgosurit;

Duke pasur parasysh të marrin eksperiencë këtë fushë;

Rekomandon qeveritë e shteteve anëtare:

1. Të jepet largim nga burgu në masën më të madhe të mundshme mjekësore, edukative, profesionale, familjare dhe arsye të tjera shoqërore;
2. Për të marrë parasysh dhënien e largimit:
 - Natyrën dhe seriozitetin e veprës penale, gjatësinë e dënimit të kaluar dhe periudha e paraburgimit tashmë e përfunduar,
 - Personaliteti dhe sjellja e të burgosurit dhe rreziku , nëse ka dhe ai që mundë ta paraqesë ndaj shoqërisë,
 - Familja e të burgosurit dhe gjendja sociale , e cila mundë të ketë ndryshuar gjatë burgosjes së tij,
 - Qëllimi i largimit, kohëzgjatja, termet dhe kushtet e saj;
3. Për t'i garantuar largimin nga burgu sa më të shpejtë të mundshëm duke pasur parasysh faktorët e lartpërmendur;
4. Për t'u garantuar largimin nga burgu jo vetëm për të burgosurit në burgje të hapura, por edhe për ato në burgje të mbyllura, po që se nuk është i pajtueshëm me sigurinë publike;

²⁸ Recommendation No.R(82)16 of the Committee of Ministers to member states on Prison leave (Adopted by the Committee of Ministers on 24 September 1982 at the 350th meeting of the Ministers' Deputies).
<https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=601648&SecMode=1&DocId=676420&Usage=2> (07.05.2013)

5. Të marrin të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që largimi nga burgu mund të jepet ku është e mundur, nën kushte mirë të përcaktuara, për të huajt familjet e të cilëve nuk jetojnë në vend;
6. Të marrin të gjitha masat e nevojshme për largimin nga burgu ku u është mundësuar personave të pastrehë me sfone të vështira familjare ;
7. Duke pasur parasysh mundësinë e dhënies së lirisë për shkelësit e subjektit “të masave të sigurisë” dhe të mbajtur nën arrest diku tjetër veç burgut.
8. Për të përdorur refuzimin e largimit nga burgu, si një sanksion disiplinor vetëm në rastet e abuzimit të sistemit;
9. Të informoj të burgosurin, në masën më të madhe të mundshme për arsyet e refuzimit të largimit nga burgu.
10. Të sigurojnë mjete, me të cilat një refuzim mund të rishikohet;
11. Të konsultohet me të tjerët, se sa me autoritetet e burgut, aty ku është e përshtatshme për të kërkuar veprimin e tyre dhe se agjencive dhe personave, të cilët mundë të kontribuojnë në funksionimin më të mirë të sistemit.
12. Për të nxjerrë mbështetjen e gjithë stafit të burgjeve;
13. Të sigurojë burimet e nevojshme për sistemin, që të funksionojnë në mënyrë efektive;
14. Të mbikëqyrë nga afër dhe të vlerësoj funksionimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e çdo sistemi nga largimi i burgut;
15. Për të mbajtur publikun të informuar gjerësisht nga synimet, funksionimi dhe rezultatet e sistemit.

KONKLUZION

Me këto akte ndërkombëtare dëshirohet të vendosen principet e gjithëpranuara për kryerjen e dënimit dhe praktikën e vendosjes me personat e burgosur, në bazë të kuptimit të deritanishëm dhe sipas cilësimeve bazike të sistemeve më të mira bashkëkohore.

Këto akte parashohin një përkujdesje dhe një konsideratë për ardhmërinë e personave të burgosur direkt pas daljes së tyre nga institucionet ndëshkuese.

Këto akte standarde parashohin që shërbimet shtetërore dhe ndërshtetërore (ndërkombëtare) dhe organizatat personave të dënuar, t’iu ndihmojnë në kufi të mundësive edhe

atë t'iu sigurojnë dokumentacion të veçantë dhe mjete të identifikimit, banesë, punë, veshmbathje serioze, e cila i përgjigjet klimës dhe kohës vjetore, si dhe mjete tjera të veçanta që të arrijnë deri te vendi i caktuar dhe të kenë mundësi të jetojnë në mënyrë normale direkt pas daljes në liri. Në mënyrë të veçantë paraqitet një bashkëpunim shumë konstruktiv dhe serioz ndërmjet përfaqësuesve të organizatave të ndryshme dhe qendrave sociale me institucionet penitenciare në funksion të realizimit të plotë të programit për lëshim (lirim), si dhe programeve të ndihmës për personat e burgosur pas lirimit.

CONCLUSION

With these international acts is aspired to set the universal accepted principles for conducting conviction and the practice of decision making for persons serving prison sentences, based to the so far meaning and according to basic qualifications of the best contemporary systems. These acts predict an attention and consideration for the future of persons serving prison sentences directly after their exit from penitentiary institutions.

These acts & standards predict that the state and international services and organizations to support convicted persons in the limits of their abilities and to provide specific documentation and identification means, dwelling place, job, serious clothes, which corresponds to climatic conditions and the season of the year, as well as other specific means to reach the designated place and have the opportunity to live normal life immediately after their release. In special way occurs a very constructive and reliable cooperation between representatives of different organizations and social centers with penitentiary institutions in function of full implementation of the program of release also the assisting programs for persons serving prison sentences after their release.

BIBLIOGRAFIA

1. Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners (Adopted by the First United Nations Congress on the Prevention of Crime and the Treatment of offenders, held at Geneva in 1955, and approved by the Economic and Social Council by its resolutions 663 C (XXIV) of 31 July 1957 and 2076 (LXII) of 13 May 1977.
[http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/Treatment Of Prisoners.aspx](http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/Treatment%20Of%20Prisoners.aspx) (accessed 02.05.2013).
2. Recommendation No.R (87)3 of the Committee of Ministers to Member States on the European Prison Rules (Adopted by the Committee of Ministers on 12 February 1987 at the 404th meeting of the Ministers' Deputies).
(<http://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstraneImage=1977676&SecMode=1&DocId=692778&Usage=2>) (accessed 02.05.2013)
3. Recommendation Rec(2006)2 of the Committee of Ministers to member states on the European Prison Rules (Adopted by the Committee of Ministers on 11 January 2006 at the 952nd meeting of the Ministers' Deputies).
<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=955747> (Accessed 07.05.2013)
4. Recommendation No.R(82)16 of the Committee of Ministers to member states on Prison leave (Adopted by the Committee of Ministers on 24 September 1982 at the 350th meeting of the Ministers' Deputies).
<https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstraneImage=601648&SecMode=1&DocId=676420&Usage=2> (accessed 07.05.2013)